

VENDIM
Nr. 222, datë 26.4.2018
PËR MIRATIMIN E LISTËS
SË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE
TË INFORMACIONIT DHE TË LISTËS SË INFRASTRUKTURAVE TË RËNDËSISHME
TË INFORMACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit, sipas aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit janë të detyruar të zbatojnë, të paktën, nivelet minimale të kërkesave të sigurisë së informacionit, të miratuara nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, si dhe të përcaktojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pikën e kontaktit, person përgjegjës për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit, dhe t’ia përcjellin atë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

4. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike monitoron zbatimin e masave të sigurisë nga operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit nëpërmjet procedurave të kontrollit.

5. Listat e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit përditësohen, të paktën një herë në dy vjet, dhe auditohen (ISA- *Information System Audit*), të paktën dy herë në vit.

6. Ngarkohen Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike dhe operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

ANEKSI NR. 1
LISTA E INFRASTRUKTURAVE KRITIKE TË INFORMACIONIT

Sektori	Nënspektori	Operatori administrues	Sistemi kritik	Rrjeti kritik
Energjia	Elektriciteti	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	Sistemi i monitorimit dhe komandimit SCADA	Rrjeti midis godinës qendrore dhe pikave të komandimit
		Operatori i Sistemit të Transmetimit	Sistemi SCADA	
Shëndetësia	-	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Sistemi i regjistrimit dhe kontrollit të barnave	
			Sistemi i ndihmës ekonomike	
			Sistemi i pagesave të aftësisë së kufizuar	
			Sistemi i shërbimeve	
		Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	Sistemi informatik i regjistrimit të recetave elektronike në RSH	
			Sistemi i nënshkrimit elektronik për qytetarët dhe profesionistët e shërbimeve të shëndetësisë elektronike (PKI)	
			Regjistri elektronik i banorëve	
Financiar	Bankar	Banka e Shqipërisë	Sistemi i pagesave	WAN,LAN
		<i>Intesa Sanpaolo Bank - Shqipëri</i>	<i>FlexCube Core Banking System</i>	WAN,LAN
		Banka Kombëtare Tregtare	Sistemi Qendror Bankar	WAN,LAN
		Banka Credins	<i>Core Banking System</i>	WAN,LAN
		Banka <i>Societe General</i> Albania	<i>Core Banking System</i>	WAN,LAN
		Banka Tirana	Sistemi Qendror Bankar	WAN,LAN
		<i>Alpha</i> Bank	Sistemi Qendror Bankar	WAN,LAN
		Banka Amerikane e Investimeve	Sistemi Qendror Bankar	WAN,LAN
		Banka NBG	Sistemi Bankar Bazë	WAN,LAN
		ProCredit Bank	Sistemi Qendror Bankar	WAN,LAN
		Banka e Bashkuar e Shqipërisë	Sistemi Qendror Bankar	WAN,LAN
		Banka e Kreditit e Shqipërisë	GOBANKING	WAN,LAN
	Tatimet	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Sistemi i administratës tatimore, sistemi i tatimpaguesve (e-Tax)	
			Sistemi i pajisjeve fiskale	
		Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Sistemi Informatik Qeveritar Financiar (Sistemi i Thesarit)	
Transporti	Transporti Ajror	<i>"Albcontrol"</i> , sh.a.	Sistemi Kombëtar i Shërbimit të Navigimit Ajror	
	-	Ministria e Mbrojtjes/Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura	Sistemi i integruar i vëzhgimit të hapësirës detare (SIHVD)	

Qeveritar			Pikat e ritransmetimit (PRT) të sistemeve radiofonike të FA	
		Ministria e Mbrojtjes	Mjediset e transmetimit të zotëruara nga AKSHI, të cilat sigurojnë komunikim dhe transmetim të dhënash	
			Qendra e ndërlidhjes e ndërtuar në Komandat e Forcave	
			Qendra e ndërlidhjes e MM/SHPFA	
			Sistemi i integruar i vëzhgimit të hapësirës ajrore (SIVHA)	
		Agjencia e Zhvillimit të Territorit	Sistemi multifunksional i qendëruar i lejeve të ndërtimit	
		Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale	Sistemi i administrimit të pronësisë industriale	
		Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Platforma qeveritare e ndërveprimit	Infrastruktura e rrjetit GovNet
			Portali qeveritar <i>e-Albania</i>	
			Infrastruktura e Çelësave Publik (PKI)	
		Qendra Kombëtare e Biznesit	Regjistri i biznesit (e-regjistër)	
			Regjistri i lejeve licencave dhe autorizimeve (<i>e-licencing</i>)	
		Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	Regjistri Kombëtar i Adresave	
			Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile	
		Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	Sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)	
		Qendra e Shërbimeve Arsimore	Sistemi i maturës shtetërore	
		Agjencia e Prokurimit Publik	Sistemi i prokurimit publik	
		Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Zyra e Gjendjes Gjyqësore (Certifikata e Gjendjes Gjyqësore)	

LISTA E INFRASTRUKTURAVE TË RËNDËSISHME TË INFORMACIONIT

Sektori	Nënspektori	Operatori administrues	Sistemi i rëndësishëm	Rrjeti i rëndësishëm
Transporti		Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	Regjistri Kombëtar i Personave të aftësuar për drejtimin e mjetit	
			Regjistri Kombëtar i Mjeteve	
Shëndetësia		Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	EHR - <i>Electronic Health Record</i>	
		Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	Sistemi <i>on-line</i> i regjistrimit të recetave dhe librezave të shëndetit	
			e-Farmaci	
			Kosto spitali	
			Sistemi për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e shpenzimeve spitalore	
			menaxhimin financiar dhe të burimeve njerëzore	
			Sistemi i auditit të sistemit financiar të FSDKSH	
			Program <i>of-line</i> Depo	
			e-Barna	
			Sistemi për integrimin, konsolidimin, monitorimin e informacionit të sistemit të kujdesit shëndetësor dhe ndërtimi i indikatorëve dhe analizave	
			SISHP	
Financiar	Bankar	<i>Union Bank</i>	<i>Oracle FCUBS 11.3</i>	WAN, LAN
		<i>"Raiffeisen Bank", sh.a</i>	<i>Core Banking System</i>	WAN, LAN
		Banka Veneto	<i>Core Banking System (XBS)</i>	WAN, LAN
		Banka e Parë e Investimeve	<i>Core Banking System</i>	WAN, LAN
		Banka Ndërkombëtare Tregtare	<i>ICBA</i>	WAN, LAN
	Tatimet	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Sistemi <i>mobile</i> (m-Tax)	
Qeveritar	-	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Sistemi informatik i integruar për shërbimet për licencimin, vlerësimin e pasurive të paluajtshme,	
			Sistemi informatik i integruar për shërbimet për licencimin në studim, projektim, mbikëqyrje e kolaudim	
		Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Regjistri i pronës	
			Regjistri i strukturave akomoduese	
		Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	Sistemi i menaxhimit të standardeve	

		Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara		Rrjeti i komunikimit me FO TR,KR,KV,FR,GJO
		Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	e-Aktet	
			<i>Electronic Record Document Management System (ERDMS)</i>	
			<i>Active Directory</i>	
			<i>Exchange(mail)</i>	
		Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Sistemi Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit	
			“Sistemi Trados”	
		Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Mësues për Shqipërinë	
		Qendra e Shërbimeve Arsimore	Sistemi Provimi i Shtetit	
			Sistemi i menaxhimit të informacionit parauniversitar	
		Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Regjistri i strukturave akomoduese	
		Ministria e Kulturës	Sistemi informatik administrues i të dhënave të trashëgimisë kulturore	
		Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Shërbimi Konsullor <i>On-line</i>	
		Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor	Gjeoportali Kombëtar	
		Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Menaxhimi i Informacionit të Sistemit Penitenciar (Menaxhimi i kartelave të të dënuarve)	
		Qendra e Botimeve Zyrtare	Sistemi i menaxhimit dhe publikimit të Fletores Zyrtare	